



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Menaxhim Infermieror”

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Elda Panariti

Dr. Maranaj Marku

Two handwritten signatures in blue ink. The top signature is more stylized and cursive, while the bottom signature is more straightforward and blocky.

Shkurt / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesionalnë: “Menaxhim Infermieror”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: “Menaxhim Infermieror”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 795, datë 06.10.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 51, datë 06.02.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023	12 PAE /5 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2021-2022 88 studentë; Viti akademik 2022-2023 52 studentë; Viti akademik 2023-2024 45 studentë;
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

UMT u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. Universiteti është i akredituar më 21. 09. 2017, me VBA nr. 69. UMT bazon veprimtarinë e vet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni neni 57, pika 6,7) dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015. Njësitë Kryesore të Universitetit të Mjekësisë Tiranë (UMT) janë:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- Fakulteti i Mjekësisë;
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim Infermieror", ka në përbërjen e vet:

- Departamentine Lëndëve Klinike Infermieristikës së Përgjithshme, Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme, Pediatri (DLKIPISBP)
- Departamentin e Lëndëve Paraklinike (DLP)
- Departamentin e Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë – Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ)

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim Infermieror" ofrohet nga FSHMT me departamentet DLKIPISBP, DLP & DDRSHIKIOGJ. Programi Master Profesional në "Menaxhim Infermieror" është licensuar sipas VKM Nr. 795, datë 06.10.2010. Këto tre Njësi bazë ofrojnë po ashtu programe studimi:

- Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator dhe në Logopedi;
- Master Profesional në Menaxhim infermieror, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator, në Logopedi, në Kujde Paliativ dhe në Infermieri Familje;
- Master i Shkencave në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator dhe në Logopedi;
- Doktoraturë në "Shkenca Mjekësore Teknike" me nënfusha (Fizioterapi dhe Rehabilitim; Infermieri dhe Mami; eknologji mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese)

Departamenti funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, për programet respektive të studimit



që ofron. Vizionii FSHMT është të vazhdojë të jetë lider në drejtimin dhe transformimin e shkencës së infermierisë në Shqipëri, si dhe mënyrën se si mësohet dhe praktikohet infermieristika.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” që ofrohet nga FSHMT në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 18-19 mars 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Dr. Elda Panariti** dhe **Dr. Maranaj Marku**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvilluan dhe takime me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike, me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit dhe me sekretarinë mësimore. Paralelisht, u zhvillua vizita në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatorin Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 86/52 Prot, datë 30.12.2024. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, njofton më datë 09.01.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 11/1, prot, datë 09.01.2025, “*Kthim përgjigje*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Menaxhim Infermieror”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. UMT vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni UMT (Statuti i UMT, neni 4) synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme në fushën e mjekësisë dhe ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Evidenca: [1]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional (MP) në “Menaxhim Infermieror” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) të UMT. Programi është miratuar si program i ciklit të dytë të studimeve me Vendim Nr. 795, datë 06.10.2010. Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se programi MP në “Menaxhim Infermieror” është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UMT dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL. Objektivi kryesor i FSHMT është formimi i profesionistëve të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore e teknike. Në rregulloren e programit të studimit theksohet se programi zhvillohet në bazë të parimeve të lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilësisë, efektshmërisë, eficientës dhe vetëfinancimit. Në rregullore deklarohet se veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve



	dhe të programeve mësimore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge europiane. Evidenca: [1], [21], [170]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	UMT dhe FSHMT e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit. Programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të FSHMT që është përgjegjës për këtë program studimi. Në dokumentin e Strategjisë së zhvillimit 4 vjeçar (2020 – 2024) theksohet se FSHMT është dhe synon të mbetet një nga njësitë qendrore më të rëndësishme të UMT si dhe të arsimit të lartë publik në Shqipëri. Për realizimin e këtij objekti FSHMT punon për ruajtjen dhe konsolidimin e programeve të studimit që ofron, dhe synon pasurimin e kurrikulës universitare me programme të reja studimi. Zhvillimi mbështetet në përmirësimin dhe krijimin e infrastrukturës së përshtatshme, pasurimin e burimeve njerëzore dhe në politika mbështetëse për studentët dhe stafin akademik. Evidenca: [1], [5], [21], [170]
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi MP në “Menaxhim Infermieror” është hartuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, strategjinë e zhvillimit institucional të UMT dhe FSHMT, strategjinë kombëtare për punësim dhe arsim, strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Evidenca: [1], [21], [170]
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje të plotë me fushën akademike të</i>

	<i>FSHMT që është përgjegjëse për këtë program studimi. Programi i studimit synon formimin e specialistëve të aftë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të ofruar kujdes shëndetësor në fushat e parandalimit, trajtimit dhe edukimit shëndetësor të popullatës. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel të kualifikuar në “Menaxhim Infermieror”.</i> <i>Ky program bazohet dhe funksionon sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMTu krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. Universiteti është i akredituar më 21. 09. 2017, me VBA nr. 69. Godina në të cilën ofrohet ky program studimi është e përshtatshme dhe gjendet në ambjentet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT). Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” është licensuar bazuar në Vendimin Nr. 795, datë 06.10.2010. Raporti i stafit akademik në FSHMT për vitin akademik 2022 – 2023 është 63 PAE dhe 242 PAK, 28 personel ndihmës akademik dhe 16 personel administrativ me kohë të plotë. Ky raport ruhet edhe në 2023 – 2024.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

7

	Kualifikimi	PAE	PAK
	Prof. Dr.	6	1
	Prof. Asoc.	17	6
	Dr./PhD	35	39
	Msc.	5	196
	Total	63	242

Pavarësisht se numri i stafit është i qëndrueshëm, *GVJ vëren se stafi me kohë të plotë duhet të shtohet*. Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e FSHMT. Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi.

Evidenca: [8], [77], [25], [80, 81, 82], [97], [117], [118], [119]

Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë;

Vizita në ambientet e FSHMT.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Fakultetit dhe në direktivat dhe Udhëzimet kombëtare e evropiane. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë. Këto tre Njësi bazë ofrojnë po ashtu programe studimi: - Bachelor në Infermierë e Përgjithshme, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laboratorit dhe në Logopedi; - Master Profesional në Menaxhim infermieror, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laboratorit, në Logopedi, në Kujdes Paliativ; - Master i Shkencave në Teknikë imazherie, në Infermierë, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laboratorit dhe në Logopedi; - Doktoraturë në "Shkenca Mjekësore Teknike" me nënfusha (Fizioterapi dhe Rehabilitim; Infermierë dhe Mami; Teknologji mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese); Programi i studimit është në përputhje dhe me Njesisë Kryesore.
--	---

	Evidenca: [1], [5], [55], [169]
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, dhe është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësive Bazë.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në përfundim të këtij programi studimi, studentët e diplomuar kanë mundësi punësimi. Me qëllim trajnimit e mëtijshëm, UMT mundohet të organizojë trajnime profesionale, përfshirë këtu workshope, leksione të hapura, seminare apo trajnime. Nuk u raportuan trajnime profesionale specifike me punëdhënësit. Për studentët e diplomuar është ofruar projekti GRADUA, trajnime e workshope me punëdhënësit. Evidenca: [15], [18], [30], [108], [124].
Konkluzione	<i>UMT u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. Pavarësisht se numri i stafit është i qëndrueshëm, <u>GVJ</u></i>

	<i>konsideron se stafi me kohë të plotë duhet të shtohet. Për këtëFSHMT duhet të punojë më shumë. Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e FSHMT. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë, pasi aplikohet nga Njësitë Bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për vlerësimin e këtij kriteri GVJ u mbështet në shqyrtimin e RVB, statutin dhe rregulloren e UMT dhe rregulloret përkatëse. Ky program është ndërtuar dhe funksionon në përputhje me këto rregullore. Rregullorja institucionit, e njësisë kryesore e njësisë bazë, rregullorja e programit të Masterit si dhe udhëzimet e lëshuara kanë përcaktuar qartë rolin dhe detyrat e aktorëve të programit, duke siguruar mbarëvajtjen e programit. Duke ju referuar analizës mësimore vjetore të punës së njësisë, si dhe takimeve me përfaqësues të departamentit dhe strukturave të institucionit konstatojmë se ka një bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë midis këtyre stukturave, që i shërben përmirësimit të punës në lidhje me zbatimin e programit të studimit. Evidenca: [1], [2], [3], [172], [173], [174], [175], [176], [179], [180], [181], [183], [184] <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njësive Bazë</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit	Me qëllim formimin e studentëve, Qendrat Spitalore Universitare janë në dispozicion të studentëve të UMT, ku ata formohen

mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	sidomos në funksion të praktikës profesionale. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njësive Bazë, u informuam se janë 85 mbikqyrës së praktikës profesionale që ndjekin studentët në terren. Gjithashtu UMT raporton 10 marrëveshje bashkëpunimi Erasmus me Institucione jashtë Shqipërisë. Evidenca: [144], [49], [44], [39], [80], [79], [97],
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në ambjentet e Qendrave Spitalore Universitare të rregulluara me VKM. UMT ofron mundësitë më të mira për zhvillimin e praktikave profesionale. Gjithashtu ka dhe marrëveshje të shumta me shumë kompani, organizata dhe universitete të tjera. Evidenca: [144], [49], [83, 84, 85], [80, 81, 82], [79, 70.1], [13.1, 13.2].
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	FSHMT ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese. Ajo përmban institucionin që është nënshkruar marrëveshja, qëllimin, përfitimet, data e nënshkrimit si dhe afati i marrëveshjes. Evidenca: [81, 82, 83]
Konkluzione	<i>UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim formimin e</i>

	<i>studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit.Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB: • Programi MP në “Menaxhim Infermieror” është program i ciklit të dytë të studimeve. • Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. • Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë. • Kohëzgjatja e studimeve është 1 vit akademik 2 semestra. • Vlerësimi në kredite: 60 ECTS (1500 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë). • 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit.

- Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 7.5 - 10/15 = 17.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta.
- Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB: 16 lëndë me 48 kredite, praktika 6 kredite + Provimi i diplomës me 6 kredite.
- Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimit teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (praktikë lëndore e profesionale). Referuar llogaritjeve në planin mësimor, orët totale janë 1500

MP në "Menaxhim Infermieror"	Në total
Në auditor	
- Leksione	294
- Seminare	63
- Projekt	2
- Praktika	390
- Provim final	150
Punë e pavarur e studentit	751
Gjithsej	1500

Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:

Kategoria	Tipi	ECTS	%	VKM
A	Lëndë Bazë	6	10 %	15-20 %
B	Lëndë karakterizuese	24.5	41 %	50-55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	17.5	29 %	12-15 %
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	6	10 %	10-15 %
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	6	10%	3-5 %

	Nga sa më sipër konstatohet se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS/përqindje <i>nuk përputhet me ato të parashikuara në VKM nr 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i>. Bazuar në këtë VKM përqindja e lëndëve të kategorisë A+B nuk duhet të jetë më pak se 60%. Në këtë program studimi këto dy kategori përbëjnë 50%. Rekomandim: <u>GVJ rekomandontë</u> rishikohet shpërndarja e ECTS-ve të lëndëve në kategori duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr 41/2018. Programi i studimit mbyllet me provim përfundimtar. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet procedura dhe kriteret e vlerësimit. Evidenca: [2], [86.1, 86.2, 86.3], [91], [97].
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale dhe shkencore të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale qëduhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e infermierisë, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin mëtejshëm të studentëve për punësim. Programi i studimit në "Master Profesional në Menaxhim Infermieror" ka qëllim të pajisë studentët me: • kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; • njohuri të mira të shërbimit shëndetësor, të higjenës, trajtimit ambulator dhe hospitalor të pacientëve.

	● aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacientëve dhe familjarëve. për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër nëtotal 60 Kredite. Programi i lëndëve është ideuar që të mundësojë pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si: Infermieristika parandaluese; Infermieristika sociale; Infermieristika në familje, koncepti dhe aplikimet e saj. <u>Në lëndë të menaxhimit shëndetsor:</u> Organizimi, Menaxhimi dhe Promovimi shëndetsor; Menaxhimi i pacientit kirurgjikal dhe post-kirurgjikal; Menaxhimi i Urgjencave Mjekësore; Kujdesi Paliativ. <u>Në Shkenca Interdisiplinare:</u> Menaxhimi i pacientëve gjatë fatkeqsive; Vaksinimi, parimet dhe menaxhimi i vaksinimit; Nutricioni i përgjithshëm & Klinik; Shëndet Mendor; Bioetika dhe komunikimi profesional. <u>Në lëndë me zgjedhje:</u> Menaxhimi i pacientit geriatrik; Psikologji shëndeti Në Praktika dhe Mikroteza. Evidenca: [86.1, 86.2, 86.3], [91], [21].
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Neni 96, pika 3e Rregullores së UMT përcakton se përfundimi i një programi Masteri Profesional përmbyllet me punim diplome. Kjo përcaktohet dhe në nenin 27, pika 3, të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe në nenin 15 të Rregullores së programit të studimit. Provimi i diplomës bëhet në tre sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejtë të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomës. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 6 kredite.

	Neni 33 i Rregullores së FSHMT përcakton praktikat profesionale. Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” dhe ka 6 kredite. Evidenca: [9], [2], [5], [21], [86.1, 86.2, 86.3], [91].
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të	Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015.

veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UMT nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private. Kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë. Përmbajtja në nivelin 70% nuk është ende përfunduar nga MAS. UMT ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	UMT ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS, gjithashtu ka zhvilluar dhe kodifikimin e lëndëve. Programi MP “Infermieri Familje” ka kodin 71MP0913S Evidenca: [55] <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UMT.
Konkluzione	<i>Programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë</i>

	për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në fushën e Infermierisë. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të UMT bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati. Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë. GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese ka shmangie nga Tabela 1 e Shtojcës 1 të VKM Nr.41. <u>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së veprimtarive në përshtatje të plotë me udhëzimin e mësipërm.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në UMT që ofron programin e studimit MP në “Menaxhim Infermieror” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. UMT është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e tij dhe zhvillon aktivitetin e tij akademik. Institucioni përbëhet nga organet akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademike (rektori, dekanët, drejtuesit e njësive bazë); organe administrative që janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësive kryesore; organe kolegjiale që janë këshilli i rektoratit, këshilli i dekanatit, këshilli etikës.

UMT ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017 datë 21.09.2017 me VBA nr. 69. Programet e studimit që ofron institucioni janë në proces akreditimi.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike në UMT që ofron programin e studimit MP në “Menaxhim Infermieror” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. FSHMT përbëhet nga 3 Departamente si më poshtë:

- Departamentin e Lëndëve Klinike Infermieristikës së Përgjithshme, Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme, Pediatri (DLKIPISBP)
- Departamentin e Lëndëve Paraklinike (DLP)
- Departamentin e Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ)

FSHMT si njësi përgjegjëse për programin e studimit, për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij gjithsej 305 staf akademik, nga ku 63 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 242 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada
Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji	27	1 – Prof. Dr. 8– Prof. Asoc. 15 – Dr. 3- Msc	95	1 – Prof. Dr. 0– Prof. Asoc. 20– Dr. 4 – Dr. në Proc. 70- Msc
Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të	21	3– Prof. Dr. 5– Prof. Asoc. 11– Dr. 2 – Dr. në Proc. 0 - Msc	130	0– Prof. Dr. 5– Prof. Asoc. 16– Dr. 5 – Dr. në Proc. 104 - Msc

	Brendshme dhe në Pediatri				
	Departamenti i Lëndëve Paraklinike	15	2 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 9 – Dr. 0 - Msc	17	0– Prof. Dr. 1– Prof. Asoc. 3 – Dr. 2 – Dr. në Proc. 11 - Msc
	Total		63		242
	Cdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku shumica prej tyre janë me gradë shkencore Prof, Prof.As dhe Dr. Sikundër shihet fakulteti përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj. Lidhur me treguesit e moshës pjesën më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë dhe gradë shkencore doktor i përkasin grup moshës relativisht të re 35-55 vjeç. Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton 12 PAE dhe 5 PAK (viti 2023-2024). Evidenca: [1], [2], [5], [77], [25], [97].				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Neni 33 i Rregullores së FSHMT përcakton rolin dhe detyrimet e drejtuesit të praktikës i cili është personel akademik me kohë të plotë. Gjithashtu, përcaktohet dhe roli i laborantit. Për mbikqyrjen dhe mbarëvatjen e praktikave profesionale, FSHMT ka përgatitur dhe Ditarin e Praktikave Profesionale që bën të mundur ndjekjen dhe vlerësimin e studentit. Stafi mbikqyrës së praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni janë staf i spitaleve universitare dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi.				

	Evidenca: [5], [97], [13.1, 13.2, 13.3]. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit ofrohet në nivel fakulteti dhe për realizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe praktikave profesionale kanë përgjegjësi të tre njësitë bazë të fakultetit. Referuar RVB-së, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Koordinatori i programit informon rregullisht drejtuesin e Fakultetit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik. Gjithashtu koordinatori i programit në mbledhjet e departamenteve mund të marrë pjesë dhe raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet si dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore/Bazë, <i>por nuk kishte një emër konkret të koordinatorit të programit. Në takimin me studentët e FSHMT, ata raportuan se nuk ishin në dijeni për koordinatortin e programit të studimit. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të vendosë dhe informojë rregullisht studentët për koordinatorin, detyrat e tij si dhe asistencën që mund të ofrojë.</i> Evidenca: [5] <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët e FSHMT.</i>
Konkluzione	UMT, FSHMT që ofrojnë programin e studimit MP në "Menaxhim Infermieror" përmbushin kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Staf akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me moshë relativisht të, re me grada e tituj ose në proces për marrjen e

	tyre. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik, personelin administrativ dhe ndihmës. Në përmbushje të kërkesave ligjore departamenti ka caktuar dhe një koordinator përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash siguron lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentet që ofrojnë programin e studimit MP në "Menaxhim Infermieror" disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin e diplomës. Me fillimin e vitit akademik, programi i studimit dhe syllabuset u vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit. <i>(Dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin	Programi i studimit MP në "Menaxhim Infermieror" është i organizuar në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje

mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore). Për secilën lëndë jepet informacioni i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, projekte dhe praktika. Programi zhvillohet në 1 vit akademik, 2 semestra dhe ka në total 60 ECTS ose 1500 orë mësimore prej të cilave 684 orë në auditor dhe 816 orë studimi individual. GVJ gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës. Evidenca: [21], [86.1, 86.2, 86.3], [91].
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e UMT. FSHMT propozon kriteret dhe kuotat e pranimit, kuotat e transferimit etj. Mbështetur në kapacitetet pritëse dhe akademike të cilat miratohen nga senati akademik dhe dërgohen në QSHA. Informacioni publikohet në faqen zyrtare on line të UMT dhe në portalin U-Albania. Institucioni nxjerr njoftime për pranimin ku përshkruhet procedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informacioni gjendet dhe në web site të UMT. Evidenca: [1], [21], [5], [132], [133], [135], [137], [139].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën	Programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Syllabuset janë të firmosura nga

lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	titullari i lëndës. <i>Bie në sy fakti që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë).</i> <u>GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore. Syllabuset janë të firmosura nga lektori (pedagogu i lëndës).</u> Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. <u>GVJ, rekomandon përditësimin e literaturës në disa prej syllabuseve.</u> Evidenca: [5], [6], [21], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me zyrën e kurrikulave;</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ konstaton se programet e studimit në UMT janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi MP në “Menaxhim Infermieror” është organizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë. Evidenca: [86.1, 86.2, 86.3], [91]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me zyrën e kurrikulave;</i>

	<i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me NjSBC;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.</i> <i>Nga analiza e dokumentacionit GVJ konstatoi që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë).</i> <i>GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore. Po ashtu, në disa prej syllabuseve duhet përditësuar literatura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të Infermierisë të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës profesionale pranë shërbimeve klinike përbëjnë 10 % të orëve në auditor. Evidenca: [91], [92].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e

semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program, si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit MP në “Menaxhim Infermieror”. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit karakterizues/profesional. Studentët kanë mundësi të aftësohen me shprehitë profesionale praktike gjatë zhvillimit të praktikave klinike mësimore. Studentët përmes programit pregatiten dhe me aftësi menaxheriale dhe klinike. Në programin mësimor studentët në fund të çdo semestri zhvillojnë praktikën profesionale pranë shërbimeve klinike spitalore bazuar në marrëveshjet që ka UMT me strukturat shëndetësore spitalore. Studenti gjatë praktikës profesionale përballet me ambientin spitalor si profesionist i kujdesit shëndetësor. Evidenca: [91].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën shumë vjeçare të ofrimit të këtij programi nga UMT si dhe mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë. Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. Projektet e mobilitetit (Erasmus+, Cost Action) si dhe projektet kombëtare të financuara nga AKKSHI në të cilat janë përfshirë staf akademik i Departamentit, studimet doktorale dhe bashkëpunimet me universitetet italiane etj. shërbejnë si një impuls i mirë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të programit. Në takimet me zyrën e këshillimit të karrierës GVJ u informua se studentët e këtij programi studimi kanë kryer transferime, studime ose të ekuivalentejnë diplomën në vende të ndryshme europiane.

	Evidenca: [21], [91]. <i>Takim me Stafin akademik;</i> <i>Takim me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Disiplinat mësimore të programit të studimit Master i Profesional në Menaxhim Infermieror, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. Veprimtaritë formuese grupohen në: - Lëndë Bazë (6 kredite, 10%); - Lëndë Karakterizuese (24.5 kredite, 41%); - Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (17.5 kredite, 29%); - Lëndë Plotësuese (6 kredite, 10%); - Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 10%); Plani mësimor përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen studentë vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 108 i rregullores së Institucionit UMT përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njësisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. Nga statistikatat e FSHMT për vitin akademik 2022-2023 ka 11 transferime në programet bachelor në infermieri, por për programin në fjalë nuk ka transferime. <i>Nga dokumentat e dorëzuara nga UMT, nuk raportohen mobilitete të studentëve por ka thirrje të studentëve për pjesëmarrje dheka rreth 10 marrëveshje bashkëpunimi Erasmus+. Gjithashtu ka pjesëmarrje të stafit akademik në këto projekte. <u>GVJ, rekomandon që UMT duhet të punojë më shumë me studentët në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në këto mobilitete.</u></i> Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve nuk punojnë në profilin e tyre. Evidenca: [1], [2], [3], [5], [6], [21], [98], [91], [167]

	<i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pedagogu i lëndës harton programin mësimor në bazë të objektivave të programit të studimit si dhe në bazë të ecurisë së shkencës së infermierisë. Syllabusi dorëzohet dhe miratohet në Departament nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartojë programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzojë atë në Departament. Literatura bazë dhe e rekomanduar përfshihet në të gjithë syllabuset e dorëzuar. <i>Disa syllabuse janë të papërditësuara në literaturë apo nuk kanë gjithë elementet e parashikuara në VKM 41, 2018, ndaj <u>GVJ</u>, sugjeron që literatura të përditësohet.</i> <i>Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës ishte viti 2018. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë shprehën idenë e përdorimit të librave online.</i> Evidenca: [5], [91], [86.1, 86.2, 86.3], [92], [113], [114]. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Master i Profesional në “Menaxhim Infermieror” u mundëson studentëve përfitimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuar në Rregulloren e programit si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit. Evidenca: [21], [86], [92]. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive bazë dhe thellimin e njohurive të përfuara në këtë program studimi në kualifikime të mëtejshme. Lëndët/modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Evidenca: [21], [108], [92]. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i> <i>Takim me studentët</i>			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit MP në “Menaxhim Infermieror” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës, si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë, si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i> <i>Disa syllabuse janë të papërditësuara në literaturë apo nuk kanë gjithë elementet e parashikuara në VKM 41, 2018, ndaj GJVJ sugjeron që literatura të përditësohet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UMT, ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesja e Njesisë Kryesore raportoi se janë përpjekur të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Nuk u dhanë evidenca nga institucioni për përfshirjen e alumni apo partnerëve në përmirësimin e programit të studimit. Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka përgjegjësi i departamentit. Në takimin e organizuar me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave ata raportuan se nuk janë përfshirë institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. <i>GVJ rekomandon që institucioni të marrë masa për përfshirjen e këtyre grupeve, pasi do ti japin mundësinë UMT të përmirësojë programin e studimit akoma më tepër.</i> Evidenca: <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i UMT, ka në përbërjen e vet dhe student, neni 25, pika 3 Statuti i UMT. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Evidenca: [1], [126], [127].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet	<i>UMT nuk raportoi bashkëpunime të ndryshme me Urdhërin e Infermierit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i>

dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Drejtuesit raportuan se mundohen të përditësojnë programin e studimit në bazë të ndryshimeve të fundit. Edhe stafi akademik e raportoi këtë gjatë takimit të zhvilluar. Institucioni ka raportuar komunikimin zyrtar me UISH me qëllim identifikimin e kalueshmërisë në provimin e liçensës. <i>GVJ, konsideron të rëndësishme ndërtimin e marrëdhënieve me UISH për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i> Evidenca: [11] <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e kohës.</i> <i>Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit për përshtatjen më të mirë të tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në procesin e rishikimit të kurrikulave studentët me anë të mekanizmave të ndryshme si plotësimi i përvitshëm i pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, këshillin studentor. Një anë positive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore. Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe atyre që kanë përfunduar studimet prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat	Programi i studimit Master Profesional në Menaxhim Infermieror është liçensuar dhe është në proces akreditimi për herë të parë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Kohëzgjatja e programit është një vit akademik dhe ofron 60 ECTS. Referuar <i>nenit 6</i> të Rregullores së programit, misioni i programit të studimit është të formojë personel infermieror që mund të ofrojë cilësinë më të lartë të kujdesit të pacientit, nëpërmjet ushtrimit të standarteve më të larta në udhëheqje, praktikë, inovacion, duke u mbështetur tek vlerat më të mira të traditës dhe të ardhmes. Programi synon gjithashtu të ofrojë informacion teorik të gjerë dhe të mjaftueshëm, duke promovuar kërkimin shkencor, i cili ndihmon studentët e interesuar të ndjekin edhe programe të tjera studimi të ciklit të dytë ose të tretë. Evidenca: [21]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Evidenca: [5], [21], [6], [93], [94]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Studentët kanë mundësinë të përdorin Konferencën Studentore për publikimin e punimeve të tyre. Staf i akademik raportoi se përfshin studentët në aktivitete kërkimore. Institucioni ka organizuar dhe një konferencë shkencore studentore ku studentët kishin mundësinë të merrnin pjesë dhe të prezantonin punimet e tyre. Evidenca: [21], [94] <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,	Njësia Bazë nuk administron të ardhura por ato menaxhohen në nivel Institucioni. Gjatë takimit me Drejtuesin e Njesisë Kryesore/Bazë ata raportuan se nuk administrojnë të ardhura.

njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikëshumë e mirë. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>			
Konkluzione	<i>Misioni dhe Veprimtaria e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 6 & 7 të Rregullores së programit të studimit. Stafi akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie.</i> <i>GVJ konstaton se Njësia kryesore/ bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore.</i> <i>Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikë shumë e mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të	Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojnë në projekte kërkimore shkencore. Anëtarët e GVB raportuan se kërkimi shkencor është një pikë e fortë, por që duhet të punohet më shumë. <i>GVJ konsideron të rëndësishme dhe <u>sugjeron</u> që numri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet.</i> Evidenca: [152], [153], [154], [181], [182]

studimit në kërkim shkencor.	<i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me GVB;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në kuadër të kërkimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Në raportin vjetor të Njesisë Bazë prezantohen publikimet e stafit akademik, ndërsa nëmënyrë të përmbledhur paraqiten në raportin vjetor të Njesisë Kryesore dhe Institucionit. Evidenca: [79], [80], [81], [82] <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucioni raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, workshope etj. të cilat u vijnë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Paralelisht, ka organizuar konferencë studentore. Aktivitetet e organizuara raportohen si në raportin e Njesisë Bazë edhe në raportin vjetor të Institucionit. Evidenca: [79], [80], [152], [153], [154], [181], [182]. <i>Takime në Institucion</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës dhe përgatitjen e specialistëve të aftë për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor në këtë fushë. Programi e arrin këtë nëpërmjet aftësimit dhe kompetencës profesionale, zhvillimit të aftësive të komunikimit midis stafit mjekësor, pacientëve dhe familjarëve të tyre, të nevojshme për t'u përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij. Evidenca: [79], [80], [81], [82], [152], [153], [154], [181]. <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e	Njësia Bazë duhet të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierit si dhe shoqatat infermierore në Shqipëri.

nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Kjo do ti japë mundësinë të formojë profesionistë më të përgatitur për tregun e punës.
---	--

Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullores të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian. Kjo vërtetohet nga momenti i hapjes së programit të studimit si dhe akreditimi institucional. Evidenca: [1], [25], [77].
---	--

Konkluzione	<i>Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojnë në projekte kërkimore shkencore. GVJ konsideron të rëndësishme dhe sugjeron që numri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet. Në kuadër të kërimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, workshope etj. të cilat u vijnë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian.</i>
--------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

35

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1																			
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.																			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi i studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale e klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshope. Në organizimin e studimeve një vend të rëndësishëm zë dhe puna e pavarur e studentit 751 orë. Tabela e mëposhtme paraqet informacion më të detajuar të përmbledhur nga tabela e planit mësimor në RVB. Diploma në total ka 1500 orë prej të cilave 749 janë orë në auditor. <table border="1"> <thead> <tr> <th>MP në "Menaxhim Infermieror"</th><th>Në total</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Orë në auditor</td><td>749 (49.9%)</td></tr> <tr> <td>- Leksione</td><td>294</td></tr> <tr> <td>- Seminare</td><td>63</td></tr> <tr> <td>- Laboratore</td><td>0</td></tr> <tr> <td>- Praktika</td><td>390</td></tr> <tr> <td>- Përgatitje e mikrotezës</td><td>150</td></tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td><td>751 (50.1%)</td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>1500</td></tr> </tbody> </table> Evidenca: [91], [92].	MP në "Menaxhim Infermieror"	Në total	Orë në auditor	749 (49.9%)	- Leksione	294	- Seminare	63	- Laboratore	0	- Praktika	390	- Përgatitje e mikrotezës	150	Punë e pavarur e studentit	751 (50.1%)	Gjithsej	1500
MP në "Menaxhim Infermieror"	Në total																		
Orë në auditor	749 (49.9%)																		
- Leksione	294																		
- Seminare	63																		
- Laboratore	0																		
- Praktika	390																		
- Përgatitje e mikrotezës	150																		
Punë e pavarur e studentit	751 (50.1%)																		
Gjithsej	1500																		
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u	Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin në formë sa më të përshtatshme për																		

përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim që mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët. Në periudhën e pandemisë, UMT, ka përdorur dhe mësimdhënien on-line si një përvojë e re në kushtet e imponuara. Evidenca: [146], [147], [148], [42], [79]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, UMT, organizon trajnime për stafin akademik. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspert nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshmes dhe website. Përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, por jo në fushën e didaktikës ndërsa përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se përmirësimi i mësimdhënies zhvillohet përmes aktiviteteve trajnuese. Evidenca: [146], [45], [19]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te	Personeli akademik, i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Stafi akademik ka aftësitë e duhura didaktike me qëllim shpjegimin në mënyrën më të mirë të mundshme studentëve. Studentët raportuan se janë të kënaqur nga mësimdhënia që zhvillon stafi akademik. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Kjo u konfirmua nga studentët. Gjatë takimit me

student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	autoritete drejtuese, ata raportuan se mundohen të rekrutojnë staf me eksperiencë në mësimdhënie. Kjo u raportua dhe në takimin me Burimet Njerëzore. CV-të e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mësimdhënie. UMT organizon aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Evidenca: [96] <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjetri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UMT përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan se vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. <i>GVJ konstatoi se plotësimi i pyetësorëve në formë elektronike nuk kishte impakt të lartë, ndaj <u>GVJ sygjeron</u> se është e rëndësishme që pyetësorët të bëhen edhe në format hardcopy, në mënyrë që të kemi gjithëpërfshirje të studentëve në këtë vlerësim. Mungesa e një raporti të tillë u raportua dhe nga përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata sugjeruan se një raport i tillë është diçka pozitive.</i> Evidenca: [67], [68]. <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i>

	<i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata organizojnë aktivitete të ndryshme duke përfshirë dhe ekspert të jashtëm. Në takimin me përfaqësues të sektorit, ata raportuan se aktivitetet që organizojnë nuk janë konkrete didaktike. GVJ, mendon se, është e nevojshme të rriten aktivitetet me qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Evidenca: [3] <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin në formë sa më të përshtatshme për studentët. Stafit akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv.</i> <i>GVJ, vëren se, trajnimet e stafit akademik janë të përgjithshme dhe jo të specifikuara në nevojat e stafit akademik. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. GVJ sygjeron se është e rëndësishme që pyetësorët të bëhen edhe në format hardcopy, në mënyrë që të kemi gjithëpërfshirje të studentëve në këtë vlerësim..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Neni 86 i Rregullores së institucionit, neni 16 i Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 17 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në syllabuset e lëndëve/moduleve raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15% 3. Aktivizimi 10% 4. Frekuentimi 5% Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, provimit të ndërmjetëm etj), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Në sezonet e vjeshtës ose të riprovimeve vlerësimi bëhet me tezë 100 pikëshe dhe vlerësimet e studentit të akumuluar gjatë vitit zerohen. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përgjindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve të zhvilluara. Vlerësimi detajohet në syllabuset e lëndëve. Evidenca: [2], [5], [21], [86.1, 86.2, 86.3], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i>

	<i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik, po ashtu dhe nga studentët. Evidenca: [92] <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas nenit 17 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato fakultative: zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlqimin e studentit. Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Evidenca: [5], [21], [86.1, 86.2, 86.3], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i>

	Takim me studentët.			
Konkluzione	Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar (70%), provimi të ndërmjetëm (15%), aktivizimi (10%) dhe frekuentimi (5%). Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektësh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e Programit të studimit (neni 16) raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15% 3. Aktivizimi 10% 4. Frekuentimi 5% Sipas nenit 17 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektësh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10

	është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lënde përcaktohen dhe dispijlohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Evidenca: [5], [21], [86.1, 86.2, 86.3], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMTKa marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Evidenca: [145] <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 88 të Rregullores së institucionit, nenit 16 të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe nenit 17 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Evidenca: [2], [5], [21], [86.1, 86.2, 86.3], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë.

profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët raportuan se në raste që kanë paqartësi mund të pyesin pedagogët për gabimet e tyre. Kjo është një procedurë që u konfirmua dhe nga stafi akademik. Evidenca: <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Përdorimi i materialeve të ndaluara, kopjimi etj. nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është i përcaktuar dhe kodi i etikës ku detajohen veprimet që nuk lejohen nga studentët, përfshirë këtu kopjimin, plagjiaturën etj. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjaturë me pagesë. Kjo u konfirmua nga drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë. Evidenca: [21], [92]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimit sipas afateve ligjore që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar dhe brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit dhe vlerësimi i tyre u bëhet i njohur studentëve nëpërmjet pedagogut dhe sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Studentët raportuan se njoftohen për pikët e provimit nga pedagogu i lëndës, sistemi Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Këtë procedurë e konfirmoi dhe stafi akademik. Evidenca: <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për

studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, <i>neni 87</i> i Regullores së Njesisë kryesore. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të deklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 25 orëve nga shpallja e rezultateve, <i>neni 92</i> i Regullores së Njesisë kryesore. Staf i akademik raporoi se ka procedurë për ankimimin e një note por asnjë nga studentët në takim nuk kishte patur një çështje të tillë pasi deri tani, çdo problematikë ishte mbyllur në nivel Departamenti. Studentët raportuan se janë në dijeni për procedurën e kontestimit të një note, në rast se ata nuk janë dakord. Evidenca: [21], [5]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas <i>nenit 92</i> të Regullores së Njesisë kryesore, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi ka kaluar nga përgjegjësi i departamentit, dërgohet te Dekani i Fakultetit, i cili ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda 24 orëve nga dita e depozitimit të ankesës Evidenca: [5].
Konkluzione	<i>Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik. Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë, aktivizim dhe frekuentim.</i> <i>Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Studenti ka të drejtën e ankimimit të rezultatit.</i> <i>Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjaturë me pagesë. Studentët kanë të drejtë të</i>

	<i>njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Menaxhim Infermieror” organizohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe mundëson formimin e thelluar profesional dhe zhvillimin e aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup etj. Programi ka kohëzgjatje 1 vit akademik dhe 60 ECTS. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studenti në auditor dhe punë e pavarur jashtë auditorit; puna e pavarur zë mbi 50% të orëve për 1 ECTS (standardi II.1, kriteri 1). Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, prezantime apo praktika profesionale. Evidenca: [91], [86.1, 86.2, 86.3], [92].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi fokusohet në përgatitjen e infermierëve për tregun e punës. Lëndë ndërdisiplinore si: Menaxhimi i pacientëve gjatë fatkeqsive; Vaksinimi, parimet dhe menaxhimi i vaksinimit; Nutricioni i përgjithshëm & Klinik; Shëndet Mendor; Bioetika dhe komunikimi profesional, këto janë lëndë të detyrueshme. Programi përmban edhe lëndë me zgjedhje: Menaxhimi i pacientit geriatrik; Psikologji shëndeti.

	<i>Programi nuk përmban lëndë Teknologji Informacioni apo në gjuhë të huaj. Sugjerohet që programi të përmbajë një lëndë të teknologjisë së informacionit, të nevojshme për nivelin aktual të shërbimit shëndetsor.</i> Evidenca: [91], [86.1, 86.2, 86.3], [92].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	MP në “Menaxhim Infermieror” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë profesionistë me kompetencën e nevojshme teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit specialist në fusha të specializuara të infermierisë. Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e veçantë në kurrikulën e programit. Në përfundim të lëndëve, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Evidenca: [86.1, 86.2, 86.3]. <i>Takimi me studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e	Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojnë orë seminare dhe praktika. Studentët zhvillojnë në total 294 orë leksione, 63orë seminare, 390 orë praktikë profesionale dhe lëndore. Stafi akademik dhe studentët raportuan se diskutimi zhvillohet gjatë orëve të mësimit me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Studentët raportuan se pedagogët mundohen të krijojnë një klimë positive duke dhënë dhe shëmbuj/raste konkrete nga puna e tyre klinike. Punimet kërkimore të studentëve janë të mundura të publikohen në revistën e FSHMT, pa pagesë. Studentët po

problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	ashtu kanë patur mundësinë të prezantojnë punimet e tyre dhe në konferencën studentore të organizuar nga FSHMT. Evidenca: [21], [91], [152], [15]. <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, organizon seminare, konferenca apo leksione të hapura, tavolina të rrumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve. Evidenca: [19], [153], <i>Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UMT mbështet idetë inovative. UMT ka organizuar konferencë studentore. Paralelisht, ambientet e Institucionit mund të përdoren nga studentët për punë kërkimore shkencore. Evidenca: [15] <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Menaxhimit Infermieror. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim të avancuar infermieror. Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e</i>

	<i>infirmieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm përmes të cilave synohet zhvillimi i aftësive në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një pregatitjeje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesëmarrjen e mjekëve të shquar vendas apo të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Studenti me përfundimin e studimeve pajset me diplomë Master Profesional në “Menaxhim Infirmieror” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UMT dhe të programit të studimit. Gjithashtu ka edhe një udhëzues për strukturën e temës së diplomës. Evidenca: [5], [9].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Fokusi i programit MP në “Menaxhim Infirmieror” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale dhe kompetencave në ushtrimin e profesionit nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme diplome. Studentët asistohen nga pedagogët e programit të studimit për provimin përfundimtar dhe në zgjedhjen e temës së diplomës. Në përfundim të lëndës studentët orientohen nga pedagogët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin, si dhe

	literaturëm që do të shfrytëzojnë. Gjithashtu, pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtar të punës. Evidenca: [5], [9]. <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Vlerësimi final i studentëve bëhet përmes provimit final. Studentëve iu vihet në dispozicion materialet e nevojshme në funksion të provimit final. Ngrihet një komision ku në përbërjen e tij ka përfaqësues nga të tre departamentet, me qëllim mbarëvajtjen e të gjithë procesit të testimit dhe vlerësimit. Evidenca: [5], [9].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Ky program studimi finalizohet me provim përfundimtar. Provimi përfundimtar ka 6 ECTS ku 150 janë punë e pavarur e studentit. Referuar Evid 9 “<i>Udhëzues për hartimin e temës së diplomes</i>”, lidhur me mbrojtje e tezës me gojë para komisionit, tema duhet të jetë e ndërtuar nga 25-30 slide. Pjesa teorike e tezës, duhet të përbëjë vetëm 10-15 % të tërësisë së slideve. Institucioni mbështet studentët në punën e pavarur për kryerjen e testimeve në ambientet e tij ose në ambientet e institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Evid 9 <i>Takim me drejtues të njësisë kryesore dhe bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit..	Institucioni krijon mundësinë dhe asistencë për realizimin e matjeve, analizave, testeve, në mjediset e veta, apo në institucionet që ka marrëveshje bashkëpunimi. Evidenca: [5],[21]

Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë	Provimi përfundimtar ka 6 ECTS ku 150 janë punë e pavarur e studentit. Sipas <i>nenit 14</i> të rregullores së programit të studimit, për të fituar diplomën “Master Profesional” studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar. Modalitetet e zhvillimit të provimit final jepen në aktet e brendshme të institucionit. Për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme.
Kriteri 7 Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e dytë të studimeve master. Procedura që ndiqet për tërheqjen e dokumentacionit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit. Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) iu vu GJV në dispozicion nga sekretaria mësimore. Evidenca: [164] <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në vizitën në sekretarinë mësimore vihet re se dokumentat e studentëve për periudhën e studimit nga hyrja në dalje mbahen, përpunohen dhe ruhen sipas rregullave përkatëse. Kjo gjë ndihmon për t'u shërbyer të interesuarve shpejt për transferim studimesh, hartimin e vërtetimeve të ndryshme, dhënje të listave të notave etj. Diplomat e Masterit Profesional regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit Master</i>

	<i>Profesional në "Menaxhim Infermieror" dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Në bazë të akteve ligjore, Spitalet Universitare janë në funksion të formimit të specialistëve të shëndetësisë, përfshirë këtu dhe programin MP në Menaxhim Infermieror. Kjo gjë garanton formim profesional të studentëve. Evidenca: [144], [79], [791], [80], [81], [82], [101] <i>Vizita në ambientet e Institucionit.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	UMT për implementimin e programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim Infermieror" bashkëpunon me Spitalet Universitare. Pranë këtyre strukturave, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë praktikën mësimore me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre. Studentët kanë mundësinë në këto spitale të përdorin teknologjinë egzistuese me qëllim rritjen e njohurive dhe kompetencave profesionale. Evidenca: [144] <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>

Kriteri 3. Praktik profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master i Profesional në “Menaxhim Infermieror” dhe ka 18 kredite (6 kredite praktikë profesionale dhe 12 kredite praktikë lëndore). Pedagogu i lëndës respektive së bashku me mbikqyrësin e praktikës vendosin notën.Në takimet në institucion, kjo procedurë u konfirmua.			
	Evidenca: [91] <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>FSHMT ka hartuar dokumentet e duhura për zhvillimin dhe ndjekjen e praktikës profesionale mbështetur në marrëveshjet e arritura.</i> <i>GVJ vlerëson se dokumentat mbështetëse që i jepen studentit janë shumë informuese dhe formuese.</i> <i>Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Në bazë të akteve ligjore, Spitalet Universitare janë në funksion të formimit të specialistëve të shëndetësisë, përfshirë këtu dhe programin MP në Menaxhim Infermieror. Kjo gjë garanton formim profesional të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

53




Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitjen profesionale, eksperiencën dhe ekspertizën e duhur mjeksore dhe pedagogjike në lëndët që mbulon. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik që është angazhuar në realizimin e programit të studimit përgjatë tre viteve akademike sipas kualifikimeve ka këtë paraqitje: <table><tr><th rowspan="2">Grada/tituj</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>7</td><td>4</td><td>7</td><td>4</td><td>7</td><td>3</td></tr><tr><td>MSc (Dr. në proces)</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>MSc</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td></tr><tr><td>Total</td><td>11</td><td>6</td><td>11</td><td>6</td><td>12</td><td>5</td></tr></table>	Grada/tituj	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	2	-	2	-	2	-	Prof.Asoc.	1	-	1	-	2	-	Dr./PhD	7	4	7	4	7	3	MSc (Dr. në proces)	1	-	1	-	1	-	MSc	-	2	-	2	-	2	Total	11	6	11	6	12	5
Grada/tituj	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof. Dr	2	-	2	-	2	-																																																		
Prof.Asoc.	1	-	1	-	2	-																																																		
Dr./PhD	7	4	7	4	7	3																																																		
MSc (Dr. në proces)	1	-	1	-	1	-																																																		
MSc	-	2	-	2	-	2																																																		
Total	11	6	11	6	12	5																																																		
	Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master Profesioanl, edhe pse një numër i vogël angazhohen edhe staf akademik me Msc (17%). <u>GVJ rekomandon</u> që, për realizimin e programit të studimit duhet të angazhohen në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.																																																							

	Evidenca: [97]										
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Evidenca 97. Tabela përmbledhëse Ascal MPMenaxhim Infermieror., tab 12.1</i>) u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për vitin akademik 2023-2024 është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2023-2024</td><td>810</td><td>348</td><td>462</td><td>43% / 57%</td></tr></table> Nga sa më sipër nuk plotësohen kërkesat ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “<i>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi</i>”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. <i>GVJ rekomandon që FSHMT, si njësi kryesore përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%).</i> Evidenca: [97], [92], [96], [13].	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2023-2024	810	348	462	43% / 57%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)							
2023-2024	810	348	462	43% / 57%							
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni pajis me kontratë punësimi personelin akademik, duke siguruar qëndrueshmërinë e personelit efektiv në periudhën e akreditimit. Personli nënshkruan kontratën individuale të punës, në të cilën janë të mbuluara edhe sigurimet shoqërore e shëndetësore. Evidenca: [157], [158], [159], [160], [161], [162].										




Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe në Rregulloren e Institucionit. Ajo bazohet në kriteret të përgjithshme dhe specifike për vlerësimin dhe përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur akademik. Departamenti është njësi bazë që inicion kërkesën për mbulimin e vakancave, duke përcaktuar edhe kriteret e posaçme në varësi të pozicionit. Pasi merret miratimi nga Dekani, Zyra e Burimeve Njerëzore procedon me publikimin dhe pritjen e kandidatëve, të cilat kalojnë në vlerësimin e komisionit ad-hoc. Në përzgjedhjen e kandidatëve zbatohen me korrektësi të gjitha elementet e rregullores, duke respektuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, e mandej në mënyrë transparente përzgjidhet kandidati fitues. GVJ zhvilloi vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku konfirmohet rregullsia në dokumentacion, si për stafin akademik efektiv, edhe për atë me kohë të pjesshme. Evidenca: [157], [158], [159], [160], [161], [162]
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve mësimore, institucioni ka punësuar personel ndihmës akademik dhe konkretisht për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar 28 personel ndihmës akademik. Evidenca: [3],[7],[21],[91]
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të	Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon konform Rregullores së UMT, ruan dhe përditëson të gjitha dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Nga vizita, zhvilluar në ambientet e UMT dhe takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me dosjet individuale të stafit dhe evidentoi ruajtjen dhe përditësimin e dokumentave të nevojshme për secilin peagog, të angazhuar konform shpërndarjes së ngarkesës mësimore, sipas




studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	planit të programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Infermieror". Evidenca: [2], [156], [157],
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	FSHMT, UMT dhe QSUT angazhojnë personel akademik. Institucioni zhvillon praktikë edhe në spitale të tjera universitare dhe institucione me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Evidenca: [49], [101], [101.1].
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në mjediset shëndetësore të institucionve me të cilat UMT ka marrëveshje, studentët zhvillojnë praktikat mësimore, të mbikqyruar nga personeli shëndetësor, si edhe anëtarit i stafit akademik i ngarkuar për praktikën mësimore. GVJ, i është vënë në dispozicion dosja e praktikës për programin e studimit "Master Profesional në Menaxhim Infermieror", në plotësimin e së cilës zhvillohen aftësi të përcaktuara infermierore. Evidenca: [13.4].
Konkluzione	<i>FSHMT, si njësi kryesore në të cilën ofrohet ky program studimi, përbëhet nga stafi akademik më kohë të plotë (PAE) dhe stafi akademik me kohë të pjesshme (PAK), me përvojë profesionale, në fushën e mjeksisë. Jo igjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi i plotëson kërkesat ligjore sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni</i>




	59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master Profesional, angazhohen edhe staf akademik me Msc (17%). <u>GVJ rekomandon që FSHMT, si njësi kryesore përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%).</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mjediset e FSHMT, ku zhvillojnë aktivitetin njësitë bazë, sallat e leksioneve, seminareve, laboreve, si edhe zyrat. Mjediset janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme – sipas mendimit të stafit akademik. Në programet e ciklit të dytë, procesi mësimor zhvillohet pasdite. FSHMT disponon këto ambiente didaktike: Salla leksioni 25, Salla seminari 15, Mjedis laborator 12, Biblioteka 1, Zyra personeli akademik 14, Zyra administrate 24. FSHMT disponon edhe një sallë leksionesh me kapacitet 250 studentë. Ambjenti i bibliotekës është vendosur në katin e pestë, me akses në internet dhe orar 8⁰⁰- 18⁰⁰. Pranë sekretarisë mësimore është atashuar edhe zyra e Informacionit në shërbim të studentëve. FSHMT disponon arkivin dhe zyrën e shërbimit informatik (IT), pjesë e administratës.





	Evidenca: [118], [119], [110], [82]. <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar RVB-së, Fakulteti disponon 2 godina, në të cilat zhvillon veprimtarinë e vet kryesore, si dhe mjedise të UMT dhe QSUT. Në godinën 1 ndodhen 6 auditorë me 500 vende, 10 salla seminari me 50 vende, 4 laboratorë me 50 vende dhe 15 zyra administrative. Në godinën 2 ndodhen 11 auditorë me 700 vende, 14 salla seminari me 50 vende, 3 laboratorë me 70 vende si dhe 21 zyra administrative. Mjediset mësimore dhe laboratorike janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, në mbështetje të procesit mësimor. Evidenca: [118], [117.1]. <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UMT, bazuar në natyrën e fushës së veprimtarisë, ka në fokus të veçantë infrastrukturën laboratorike dhe praktike. Veç mjediseve të QSUT, UMT disponon 72 laboratorë të dedikuar për veprimtari akademike. Shumica e laboratorëve janë investim i drejtpërdrejtë i institucionit. Një sasi e vlerësueshme laboratorësh vijnë nga bashkëpunimet me partnerët, projektet apo donacionet. Në FSHMT, në partneritet me projektin HAP janë ndërtuar 2 laboratorë modernë për infermieristikën, në kuadër të hapjes së programit MP në Menaxhim Infermieror dhe shërbejnë edhe për këtë program studimi. Evidenca: [79], [117], [117.1], [118], [119]. <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me	Në UMT, mjediset akademike dhe administrative janë të pajisura me mbulim interneti dhe Wi-Fi. Në dispozicion të studentëve janë 8 salla informatike me kapacitet prej 200 kompjuterash.

programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Evidenca: [118]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	UMT, FSHMT dhe QSUT garantojnë kapacitet dhe shërbim të përshtatshëm për zhvillimin e praktikave mësimore. Institucioni ka marrëveshje edhe me shërbime të tjera universitare dhe institucione të tjera, për realizimin e praktikave. Evidenca: [48], [49], [101]			
Konkluzione	<i>Bazuar në materialet e vëna ne dispozicion dhe vecanërisht ne vizitën që GVJ zhvilloi në institucion, jemi të mendimit se UMT ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi mjedise mësimore dhe infrastruktura të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor, si dhe për formimin praktik, në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset lëndore, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme sipas fushave specifike të lëndëve përkatëse. Literatura e sugjeruar gjendet në formë fizike apo elektronike dhe vihet në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (në shqip). Studentët dhe pedagogët komunikojnë edhe nëpërmjet platformës elektronike googleclasroom për materiale dhe informacion. Evidenca: [42], [23], [113], [114], [150].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Mbi përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse, GVJ vëren se në disa raste në programet lëndore rekomandohet literaturë e vjetër ose mungon viti i botimit. Nga biseda me stafin, pedagogët shprehin se përditësojnë leksionet e tyre (dispencat) me literaturë bashkëkohore, si një mundësi për të qënë më fleksibël në përditësimin e literaturës për studentët. <i>Edhe pse shohim përpjekje të njësive bazë për përditësimin e literaturës, GVJ mendon se ka mangësi në pasqyrimin e literaturës bashkëkohore.</i> Evidenca: [11], [11.1], [92]. <i>Takim me stafin</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMT ve në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore të FSHMT, si dhe Bibliotekën Qëndrore të Universitetit me histori 70 vjeçare. Nga evidencat e vëna në dispozicion vlerësojmë se, studentëve u krijohet mundësia të shfrytëzojnë fondin fizik dhe dixhital të librit në mënyrë të barabartë. Biblioteka është struktura që funksionon në përputhje me nenin 30 të Ligjit 8576 dt. 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”. Biblioteka qëndrore dhe bibliotekat e Fakulteteve garantojnë shfrytëzimin në mënyrë të barabartë nga studentët. Evidenca: [24], [113]. <i>Vizita në institucio</i>

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Fondi i bibliotekës qendrore përmban një numër vëllimesh prej 53000 libra, 18000 revista shkencore, koleksione si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj. Është një fond me histori 70 vjeçare, që garanton mbulimin e të gjitha moduleve dhe veprimtarive mësimore. Biblioteka qendrore dhe bibliotekat në rang fakulteti janë salla fizike për ofrimin e studimit. Anëtarësimi është falas, anëtari pajiset me kartelë dhe librezë anëtarësimi. Biblioteka është e pajisur edhe me fondin elektronik i cili disponohet online në linkun https://library.rash.al me klikim në biblioteka online në faqen kryesore të UMT. Evidenca: [113]. <i>Vizitë në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni garanton shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në bibliotekat online për fushën e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror” Studentët mundet të anëtarësohen në U-Library, Telemedicinë, Hinari vullnetarisht dhe pa pagesë. Evidenca: [24], [113], [114].
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi edhe mjediset e bibliotekës së FSHMT, e cila gjendet në mjediset e fakultetit. Ajo përmban botime në formën e teksteve mësimore, punime shkencore, punime studentësh në formë fizike. Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje elektronike, në dispozicion të pakufizuar për studentët. Telemedicina, gjithashtu është biblioteka elektronike që vihet në dispozicion nga UMT Evidenca: [146]. <i>Vizitë në institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Biblioteka funksionon sipas rregullores së brendshme bazuar në nenin 39 të Rregullores së FSHMT. Mjedisi i bibliotekës vihet në dispozicion të studentëve nga ora 8⁰⁰ deri në 18⁰⁰, në përshtatje me orarin e zhvillimit të procesit mësimor paradite dhe mbasdite dhe konceptohet si mjedis studimi e jo vetëm, por

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

62

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	edhe diskutimi apo organizimi të takimeve të ndryshme. E konceptuar në këtë mënyrë, sipas RVB, shprehim mendimin se nuk realizon qëllimin pavarësisht kompensimit nga Biblioteka Qëndrore. <i>GVJ sugjeron përditësimin e fondit, i cili rezulton me tekste mësimore të botimeve të vjetra, si dhe përafrimin me Bibliotekën Qëndrore të UMT.</i> Evidenca: [113]. <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në përmbushje të këtij kriteri mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik ose online nga personeli akademik dhe studentët e programit të studimit” Master Profesional “Menaxhim Infermieror”, shfrytëzimin e sallave të studimit dhe eficiencën e përpjekjeve të pasurimit të fondit fizik dhe online, RVB e evidenton në materialin e analizës vjetore FSHMT. GVJ, konstaton se fondi fizik i librit është i vjetër, nuk ka përditësimin e nevojshëm dhe teknologjia në përdorimin e fondit online është e varfër, në bibliotekën e FSHMT. <i>GVJ, sugjeron përditësimin e fondit fizik dhe përmirësimin apo plotësimin me teknologji bashkëkohore të mjediseve të bibliotekës FSHMT, për avancimin në përdorim të fondit online.</i> Evidenca: [113], [80], [81], [82].
Konkluzione	<i>Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të programit të studimit MP në Menaxhim Infermieror, është në përputhje me fushën e studimit, por ka vend për përmirësime për të qënë bashkëkohore.</i>

	Po ashtu edhe të dhënat mbi fondin fizik të librit nuk janë të plota dhe të sakta. Në programet lëndore, literaturat pjesërisht janë të vjetëruara apo literaturat e sugjeruara mungojnë. Literatura bazë apo e rekomanduar nuk gjendet shpesh në bibliotekën FSHMT. Mjediset e bibliotekës ofrojnë mundësi të barabarta dhe kohë të mjaftueshme shfrytëzimi, regjistrim falas si për fondin fizik dhe atë online. <u>GVJ sugjeron përmirësimin dhe përditësimin e fondit fizik dhe mirëmenaxhimit të fondit online të bibliotekës, shfrytëzimin më të mirë të platformave U-Library apo Telemedicina.</u> Studentëve të këtij programi studimi u krijohet mundësia të përdorin bibliotekën qendrore të UMT, me fond të respektueshëm e të plotë fizik e online. Vërejtjet e sugjerimet tona shkojnë në synim të përmirësimit të vlerave të bibliotekës FSHMT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në paraqitjen e RVB, si edhe përgjatë vizitës në Institucion, në takimet me Shefin e Departamentit, Stafin dhe Sekretarinë Mësimore, konstatojmë se UMT disponon sistem të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët, si dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim. Informacioni i ruajtur në regjistra në formë manuale, nga regjistrat e kursit deri në regjistrat e sekretarisë mësimore, si dhe informacioni në formë elektronike (proçesverbalet në sistemin Pitagora dhe në hard-copy) figuron i rregullt.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

64

	Evidenca: [40], [42], [149], [150].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ, konstaton se, nëpërmjet sistemeve të brendshme të menaxhimit Pitagora dhe Easy Web administrohet informacioni dhe dokumentacioni i të gjithë aktorëve dhe partnerëve të angazhuar në procesin mësimor, personel akademik, ndihmës akademik, administrativ, në realizimin e programit. Evidenca: [40], [41], [42], [43].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, konstaton se, në respekt të kuadrit ligjor dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sistemi i menaxhimit garanton dhe siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e Programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”. Evidenca: [40], [41].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemeve të menaxhimit, Pitagora dhe umed.edu.al, mundësohet komunikimi interaktiv, i shpejtë dhe i saktë i informacionit në lidhje me procesin mësimor, vlerësimet, kreditet, mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ndërkohë që, nëpërmjet platformave Moddel, umed.edu.al, UMT Easy Web realizohen komunikime dhe shkëmbime të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. UMT ka akses edhe në rrjetin Akademik Shqiptar. Evidenca: [41], [20], [142].
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ, vëren se, edhe në sajë të dixhitalizimit, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si edhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale, për organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të UMT. Evidenca: [40], [41], [42].

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në WEB faqen e UMT, informacionet që lidhen me Programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”, personelin akademik, aktivitetet institucionale publikohen në Gjuhën Shqipe dhe Angleze. FSHMT ka faqen e vet aktive dhe dinamike me aktivitetin e Fakultetit. Evidenca: [168], [12].			
Konkluzione	<i>UMT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit instucional, i cili edhe në sajë të dixhitalizimit, vihet në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ, për programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”, duke përmbushur plotësisht Standardin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ i është vënë në dispozicion evidenca me të dhëna mbi koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi. Gjithashtu, disponojmë edhe evidencat me miratimin e Buxhetit 2022 nga Bordi i Administrimit, miratimi i Regjistrat të prokurimeve dhe shërbimeve. Duke qenë institucion publik, UMT i siguron fondet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e Universitetit. Evidenca: [73], [75].

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetur në RVB dhe në evidenca, vërejmë se në fund të çdo viti akademik njësia bazë harton një raport financiar dhe në çdo fillim viti akademik harton planin për mbështetje financiare të njësisë me zëra për mirëmbajtje mjedisore, mbështetje në teknologji, aktivitete, literaturë, akses në biblioteka online, etj. Proçesi i hartimit të buxhetit nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë dhe strukturat administrative. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Evidenca: [2], [5], [52], [53].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Konform legjislacionit në fuqi, UMT i nënshtrohet në vazhdimësi auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacionin. Në UMT funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm, UMT i nënshtrohet periodikisht edhe Auditit të jashtëm. Evidenca: [5], [50], [51].
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përmbushje të këtij kriteri, citojmë nga RVB se: Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit, i cili u bëhet me dije anëtarëve të njësisë bazë. Raporti është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare. Ai është pjesë e Raportit Vjetor Institucional. Evidenca: [79], [79.1], [80], [81], [82], [83], [84], [85].
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e	Si institucioni publik, me numër të konsiderueshëm studentësh dhe programe studimi, UMT garanton qëndrueshmëri financiare në zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë si edhe

programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	kapacitete financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. UMT ka të drejtën të mbledhë fonde jashtë buxhetit të shtetit, sipas rregullave në fuqi dhe gëzon të drejtën të realizojë marrëveshje të pavarura me institucione publike e private për mbështetjen e studentëve. Evidenca: [52], [54], [88].			
Konkluzione	GVJ ka bindjen dhe gjen në evidenca dhe raporte se UMT garanton financimin dhe mbështet financiarisht realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor dhe siguron mbarëvajtjen e programit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”, si edhe mbështetjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin	GVJ konstaton se, Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë të studimeve Master Profesional në Menaxhim Infermieror, që nga momenti i

e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	regjistrimit deri në diplomim, në përputhje me aktet e veta normative dhe rregullatore të përcaktuara në Statutin e UMT, Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Programit të Studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror” si dhe tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH. Evidenca: [1], [2], [5].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se, politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë, gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin, për të gjithë kandidatët dhe mandej studentët e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”. Në auditorët e FSHMT ofrohen facilitete për aksesueshmërinë e tyre nga persona me aftësi ndryshe. Evidenca: [2], [5].
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ konstaton se, UMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik, kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Këto kriteret miratohen me vendim Senati, i cili publikohet online në faqen e web-it të UMT. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, bazuar në ligjin dhe udhëzimet përkatëse të MAS. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj vërtetojmë se për këtë program studimi nuk ka kriteret specifike. Por ky program i përket nivelit të dytë të studimeve dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me maturën shtetërore dhe strukturat në zbatim të saj. Evidenca: [2], [5], [132].
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të	Në RVB thuhet, dhe ne biem dakort se, kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi gjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku i gjerë, pasi janë të përcaktuara në rregulloren e FSHMT, si dhe mund të aksesohen lehtësisht në çdo kohë online në websit-in e UMT dhe FSHMT.

kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Evidenca: [34], [137], [143], [168].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, në afatet kohore të përcaktuara nga MAS, në UMT organizohen ditët e informimit të maturantëve dhe të interesuarve. Informacioni jepet në takimet që organizon stafi i ngarkuar për promocion, shpërndahen fletëpalosje me informacionin e nevojshëm apo gjendet në faqen e webit të UMT e FSHMT. Evidenca: [12], [143], [168], [123].
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ, gjen se, UMT parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi ndryshe, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kriteret e vendosura për këtë kategori janë të njëjta me ato të vendosura nga MASH. Evidenca: [137], [98].
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, gjen se, UMT harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Nëpërmjet faqes web të UMT, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së Karrierës dhe Këshillimit, ofrohen informacione për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Evidenca: [133], [139].
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ, vërteton se UMT harton politika të ndihmës/bursa dhe në cdo fillim viti akademik kryen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UMT. UMT ofron bursa studimi për studentët me mesatare me të lartë. Evidenca: [135], [139], [70].
Konkluzione	<i>UMT harton, ndjek dhe zbaton procedura konkrete për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve, në përputhje me legjislacionin në</i>


	<i>RSH, aktet ligjore dhe nënligjore, mbështetur në Rregulloret përkatëse Institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, vëren se institucioni ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Të dhënat publikohen në faqen e web-it të UMT, afishohen në mjediset e FSHMT pranë tabelës së njoftimeve. Në cdo fillim viti akademik, studentët informohen për kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, numrin e krediteve të nevojshme, ndërsa mbi rezultatet e provimeve njoftohen nëpërmjet sistemit Pitagora. Informacioni mbi ecurinë e studentëve disponohet edhe nga Zyra e sekretarisë mësimore e cila ua ofron palëve të interesuara. Qartësojmë se ky është MP me kohëzgjatje një vjeçare. Studenti mund t'i shtrijë studimet 1+1 vite. Evidenca: [2], [5], [21], [92].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve UMT dhe Rregulloren e FSHMT, institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, ose studimeve të pjesshme, aktivizon Komisionin e ekuivalentimit të moduleve dhe programeve ngritur në Departament, i cili bën vlerësimin e dosjeve dhe rankimin e kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara dhe harton listën përfundimtare me vlerësimet për secilin kandidat. Evidenca: [2], [5], [21].

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror” si dhe në Programet lëndore, në çdo fillim viti akademik, Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e moduleve përkatëse informojnë studentët mbi procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve e më specifiku me elementët e vlerësimit të njohurive, pikëzimin dhe konvertimin në notë. Evidenca: [21], [92].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Shlyerja e detyrimit final në këtë program studimi bëhet me provim final të diplomës. UMT ka hartuar një rregullore të posaçme për provimin e diplomës. Rregullorja e Projektit të Diplomimit, Rregullorja e FSHMT dhe Rregullorja e Programit të studimit përcaktojnë parakushtet dhe procedurat e diplomimit. Evidenca: [2], [5], [6], [21].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në lidhje me promocionin për këtë program studimi dhe për çdo program tjetër, GVJ konstaton se, UMT organizon takime të hapura informimi dhe shpërndan fletëpalosje në çdo fillim viti. Gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare, sekretarive dhe stafit akademik ofron informacion të vazhdueshëm për publikun e interesuar.
Konkluzione	<i>UMT ve në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të detajuar mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve në programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”</i> <i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, përfshirë, procedurat e pranimit të studentëve, transferimin dhe njohjen e krediteteve, procesin dhe komponentët e mësimdhënies si dhe diplomimin.</i> <i>Politikat, procedurat dhe kriteret e pranimit në programin e studimit si dhe zhvillimit të ciklit akademik janë transparente,</i>

	<i>bëhen të njohura publikisht dhe mundësojnë barazi dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ, vëren se, informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, transmetohet tek studentët nëpërmjet faqes zyrtare, zyrës të sekretarisë mësimore, personave përgjegjës në departament, nga momenti kur kandidatët për studentë paraqesin interes në vazhdimësi. Në fillim të vitit akademik studentët informohen nga pedagoët e lëndës në lidhje me përmbajtjen dhe detyrimet e lëndës. Informacion i detajuar gjendet edhe në Kurrikulën e Programit. Evidenca: [21], [143], [109].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të cdo viti akademik, përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e lëndëve përkatëse informojnë studentët për modulet/lëndët, përmbajtjen, numrin e krediteve për cdo lëndë, si dhe veprimtarinë formuese. Studentët aksesojnë të dhënat nëpërmjet llogarisë së dedikuar te Pitagora. Githashtu, informacioni gjendet i publikuar në faqen e WEB-it të FSHMT sipas zërave përkatës. Në vazhdimësi studentët asistohen edhe nga sekretaria mësimore. Evidenca: [168], [86], [92].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i promovon në tregun e punës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si veprimtari jashtë mësimore. Në UMT funksionojnë

institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	këshilla studentorë të cilët funksionojnë edhe si tutoriat studentor, ku studentët e viteve të shkuara shërbejnë si transmetues i eksperiencave personale. Tutoriati funksionon edhe në nivel akademik. Në panairin vjetor të punës, një vend i veçantë i dedikohet ALUMNI, me raste suksesi të studentëve të diplomuar në UMT. Evidenca: [107], [108], [124], [125], [126], [127].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve të sapoardhur në cdo fillim viti akademik, u jepet informacion i gjerë dhe i detajuar mbi mënyrën e organizimit të procesit mësimor në leksione-seminare-labratore, logjistikën infrastrukturën e FSHMT- sallat e leksioneve-seminareve-laboratorëve dhe shërbimet ndihmëse, si dhe organizimi i praktikave profesionale. Në orarin mësimor pasqyrohen të dhënat e nevojshme. Ai afishohet në tabelën e njoftimeve në mjediset e FSHMT dhe u dërgohet studentëve në formë elektronike. Evidenca: [118], [123], [143]. <i>Takim me stafin</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet llogarisë personale në platformën Pitagora, studentët mund të marrin informacion të përditësuar mbi programin e studimit, modulet dhe lëndët, pedagogët përgjegjës dhe rezultatet në provime. Nëpërmjet adresës personale në platformën Pitagora të aksesueshme kudo dhe në cdo kohë, studentët mund të komunikojnë edhe me stafin akademik. Evidenca: [150], [40].
Konkluzione	<i>UMT, zotëron kapacitetet e nevojshme për tu mundësuar studentëve të këtij program informacion mbi komponentët e programit të studimit. Studentët informohen jo vetëm mbi përmbajtjen e programit mësimor, por edhe mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të programit të studimit.</i> <i>Informacioni u vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet strukturave të dedikuara. Ky informacion mund të aksesohet</i>




	<i>edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit me anë të përdorimit të platformave dhe sistemeve dixhitale të komunikimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UMT disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit “Master Profesional Në Menaxhim Infermieror”. Njësitë që i disponojnë këto të dhëna janë Sekretaria mësimore, njësia bazë, si dhe Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Konkretisht të diplomuar në programin e studimit MP në Menaxhim Infermieror: - Për vitin 2020-2021 ka 94 studentë; - Për vitin 2021-2022 ka 87 studentë; - Për vitin 2022-2023 ka 57 studentë; Evidenca: [108], [164].
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	UMT dhe FSHMT disponojnë statistika vjetore të sakta për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”, tërheqjet dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të cdo viti akademik. Të dhënat menaxhohen nga sekretaria dhe sistemi Pitagora. Në programin e studimit MP në Menaxhim Infermieror, regjistrimet e studentëve rezultojnë: - për vitin 2021-2022 88 studentë; - për vitin 2022-2023 52 studentë;

zhvillohet programi i studimeve.	- për vitin 2023-2024 45 studentë; Gvj konstaton rënie të nr të studentëve të regjistruar nga viti në vit, që është këmbanë alarmi për programin Master Profesional. Sugjerojmë, rishikimin e kuotave si dhe një studim tregu. Evidenca: [164], [40]. <i>Vizita në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i brendshëm i informacionit në UMT, i përfaqësuar nga dy strukturat përkatëse Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria Ekonomike, menaxhon të dhënat statistikore të studentëve. Të dhënat janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar (sekretaria, pedagogët, IT) të cilët plotësojnë kriteret që përcaktohen nga ligji, për mbrojtjen e të dhënave personale. Evidenca: [2], [180].
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas RVB, dhe nga takimet e zhvilluara në Institucion, Njësia e Auditit të Brendshëm ushtron veprimtari ligjzbatuese, Njësitë përkatëse të administratës në UMT, si edhe Dekanatet e Departamentet, mbështesin me akte përkatëse kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin: sekretarinë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, duke mundësuar vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes, saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre. Secili nga aktorët, ka akses në çdo kohë për vlerësimin apo kontrollimin e veprimtarisë administrative apo mësimore. Evidenca: [3], [51], [177].
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	Nga takimi në FSHMT, si dhe të dhënat e RVB, konkludojmë se, Fakulteti analizon ecurinë e studentëve nga hyrja në dalje, si dhe harton raporte periodike mbi kalueshmërinë dhe cilësinë. Në sajë të bashkëpunimit që FSHMT ka me UISH, merr të dhëna mbi licensimin dhe punësimin e studentëve. <i>Por kjo e dhënë nuk është e plotë për ALUMNI. Gvj sugjeron: Mbi bazën e këtyre treguesve, të merren masa për përmirësimin e treguesve cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, apo edhe një ristudim tregu</i>




përmirësimit të këtyre treguesve.	do të ishte i nevojshëm në situatën aktuale për të rivlerësuar kërkesën për Programin Master Profesional.			
	Evidenca: [80, 81, 82], [164], [180].			
Konkluzione	UMT mbledh, administraton, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit "Master Profesional në Menaxhim Infermieror", nga pranimi deri në diplomim, si dhe bën përpjeke për grumbullimin e të dhënave mbi punësimin e tyre, të cilat duhet të jenë më të plota dhe më të sakta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Statutin e UMT, Rregulloren e FSHMT si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, studentëve u garantohet e drejta e përfaqësimit në organet e vendimarrjes dhe këshilluese, Senatin Akademik, KIZ, KZF, NJSBC, RVB, komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Përfaqësuesi studentor, votohet dhe zgjidhet nga vetë studentët. Studentët zgjedhin përfaqësuesin e tyre edhe për Këshillin Studentor. Evidenca: [1], [2], [5].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin	Nga takimi me studentët e FSHMT, si dhe nga analiza RVB, GVJ, vëren se, përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik është reale, konkrete, e verifikueshme dhe e matshme. Me studentët zhvillohen takime me transparencë të plotë dhe studentët ndjehen të vlerësuar. Në pyetësorët që zhvillon

akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	periodikisht UMT, një zë i vecantë i takon edhe garantimit të pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje. Evidenca: [5], [126], [127], [124], [125], [100]. <i>Takim me studentët e FSHMT</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Duke qënë aktor dhe faktor i rëndësishëm për Fakultetin, përmes anketave, pyetësorëve fizikë online, Fakulteti garanton përfshirjen e tyre në procesin e hartimit, nënshkrimit dhe përmirësimit të programeve. Evidenca: [27], [60], [62], [67]. <i>Takim me studentët e FSHMT</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve FSHMT, studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, zgjidhjen e tezës, të ankimohen për rivlerësim, të rivlerësohen nga i njëjti komision apo nga komision tjetër. Këto janë hallka të një procesi transparent që aplikohet në Departament. Në kuadër të marrëveshjes për implementimin e CLEAN SCORE, procesi i vlerësimit do të jetë më transparent. Për vitin 2023-2024 ky kriter nuk është aplikuar në këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>UMT përfshin dhe organizon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Infermieror" Por për këtë program studimi vihet re rënia progresive e numrit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në shërbim të informimit të studentëve, GVJ, konstaton se, UMT ve në dispozicion njësi të posaçme të informimit dhe shërbimit: Zyra e IT, Sekretaria Mësimore, zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Karriereës dhe ALUMNI. UMT ve në dispozicion të studentëve rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar. Evidenca: [1], [3], [164], [110], [107], [69].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ vëren se, informimi, këshillimi dhe ndjekja e përparimit të studentëve është kompetencë dhe detyrim i Shefit të Departamentit dhe pedagogëve të moduleve përkatëse. Gjithashtu sistemi Pitagora vihet në dispozicion për të gjithë studentët. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. Evidenca: [2], [5], [6], [21], [92].
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën	UMT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe ALUMNI. Studentët informohen dhe orjentoohen për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se për pjesën më të madhe të tyre, Zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës funksiononte në mënyrë të vazhdueshme duke mbajtur leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panairët e punës. Evidenca: [108], [108.1].

profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe ALUMNI ndjek studentët e diplomuar në tregun e punës. Ajo është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mbi shkallën e punësimit dhe nivelin e punësimit, ndjek ecurinë e të diplomuarve në tregun e punës dhe mban kontakte me ta. Zyra e Karrierës dhe ALUMNI-t përgatit raporte statistikore lidhur me përqindjen e studentëve të punësuar. Por, GVJ vëren se, të dhënat e kësaj zyre nuk janë të plota. Edhe në takimet me stafin e përfaqësues të zyrës, ata u shprehën se është e vështirë të mbahet kontakt me të diplomuarit, të cilët shpesh ndërrojnë të dhënat ose shfaqin indiferencë. Dhe kur diskutohen të dhënat e punësimit si brenda dhe jashtë vendit, shifrat qëndrojnë larg reales. <u>Sugjerimë:</u> të gjenden ura komunikimi me të diplomuarit, që së paku para se të tërheqin diplomën të rifreskojnë të dhënat e tyre dhe në vazhdim. Evidenca: [2], [108], [108.1], [107].			
Konkluzione	UMT ka struktura të dedikuara për këshillimin, asistimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve si dhe një sistem menaxhimi për ofrimin e informacionit mbi procesin mësimor dhe programin e studimit. Strukturat kompetente orientojnë studentët në tregun e punës si dhe zhvillimin e karrierës. Këto struktura ndjekin në vazhdimësi karrierën e studentëve të diplomuar nëpërmjet kontakteve edhe pas diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

80




Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UMT bazohet në planin strategjik të zhvillimit të UMT-së 2021-2024. Në përshtatjen me kërkesat e kohës, UMT harton udhëzues që nxisin zhvillimin me mjete të tilla si: Mësimdhënia në distancë, apo të mësuarit me qëndër studentin, përdorimi i mjeteve bashkëkohore dhe metodave inovative janë bërë praktikë edhe në Programin e Studimit Master Profesional në Menaxhim Infermieror. Evidenca: [1], [2], [170].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Dekanati i FSHMT, si dhe njësitë përkatëse të vlerësimit dhe monitorimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik si Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bëjnë të mundur që përmes pyetësorve apo pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore-shkencore, vlerësojnë periodikisht mbi metodat inovative që aplikohen gjatë procesit mësimor. Evidenca: [79], [67], [68], [180], [27], [28].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UMT, në nivel institucional ka ngritur Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili bazuar në ligj dhe aktet nënligjore, harton pyetësorin e studentëve për matjen e performancës, për cilësinë e mësimdhënies në cdo program studimi. Kjo njësi mbështetet edhe nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, një anëtar i të cilit është student, në nivel Universiteti e Fakulteti. Evidenca: [1], [169].
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	Pyetësori i përgatitur nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i plotësuar nga studentët në cdo fund semestri, analizohet nga strukturat përgjegjëse. Raporti publikohet edhe në faqen zyrtare të UMT.




mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Evidenca: [62], [67], [68], [79.1], [170], [27], [28].			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në RVB, dhe takimet në institucion, UMT, në vecanti NjSBC, vlerëson rezultatet e marra nga pyetsorët, raportin e analizës vjetore të fakultetit dhe universitetit dhe bën publikimin në faqen zyrtare të UMT. Veprimtaritë dhe praktikatat më të mira si leksione të hapura, workshope, aktivitete të tjera i publikon si modele në faqen zyrtare. Evidenca: [79], [79.1].			
Konkluzione	<i>Rritja e cilësisë së mësimdhënies është një nga prioritetet e strategjive zhvillimore të institucionit. UMT ka ndërmarë masat e nevojshme në realizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative dhe metodave kreative të mësimdhënies. Aktet regullatore të institucionit kanë parashikuar ngritjen e strukturave përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies.</i> <i>Nëpërmjet mekanizmave stimulus, institucioni nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e	Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënigjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale, UMT ka hartuar rregulloren, në të cilën përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e Standardeve të Cilësisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua lidhur me

nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	pyetësorin që realizohej tek studentët, i përbërë nga disa rubrika që lidheshin me mësimdhënien, korrektësinë e stafit akademik, programin që ata ndiqnin etj. Ky pyetësor menaxhohej nga NJSBC Evidenca: [1], [3], [100], [76].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me Standardet Shtetërore të cilësisë, të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë elementet e programeve të studimit të ofruara nga UMT, është ngritur dhe funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, i përbërë nga anëtarë të personelit akademik dhe studentë, i cili ka për qëllim garantimin e Standardeve të Cilësisë së UMT dhe Programeve të Studimit. Evidenca: [1], [69], [3], [5], [180], [76].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ, gjen se, Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet procesit të vlerësimit të brendshëm institucional ose të programeve të studimit. Instrumentat e përdorur janë pyetësorët për vlerësimin e studentëve, anëtarëve të stafit akademik, vetëvlerësimi i pedagogëve e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. Për sigurimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, UMT bashkëpunon me ASCAL për vlerësimin e programeve të vecanta apo edhe në rang institucioni. UMT i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional. Evidenca: [141], [169], [180].
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore	UMT, nëpërmjet NJSBC, si njësi e posaçme përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. NJSBC mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore, disiplinave mësimore, si dhe harmonizimin e tyre. Periodikisht rishikohen dhe përmirësohen programet ekzistuese. Gjithashtu çdo fundviti Përgjegjësit e Departamenteve plotësojnë performancën e stafit akademik.

institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Evidenca: [83], [169].			
Konkluzione	<i>UMT harton dhe zbaton politika dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Infermieror", në kuadër të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> <i>Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj është pjesë e objektivave zhvillimore të Universitetit. Në nivel institucional është ngritur dhe funksionon një sistem efikas i sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sigurimi i cilësisë mundësohet nga një sërë strukturash të cilat nëpërmjet kompetencave të tyre garantojnë cilësinë institucionale dhe të programeve të studimit që ofron ky institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive,	Në UMT zhvillon aktivitetin e vet, Drejtorja e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila mbulon aspektet kurrikulare dhe ato të sigurimit të cilësisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me Statutin e UMT. Kjo njësi orienton, monitoron dhe vlerëson programet e studimit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përfshihen në Raportin Vjetor të FSHMT dhe UMT. Evidenca: [79], [79.1], [80], [81], [82], [169]

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

84

motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Sipas RVB, Departamentet e FSHMT dhe Dekanati i FSHMT, në fund të vitit akademik, përgatisin analizën vjetore të fakultetit të cilën ja dërgojnë Senatit të UMT. Komunikimi i këtij informacioni në Senatin Akademik krijon mundësi të mirë për të përmirësuar dhe garantuar rritjen e cilësisë së programeve të studimit. Evidenca: [79], [80], [81], [82], [169].
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të	Bazuar në Rregulloret dhe Strukturat përkatëse, UMT përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit. Instrumentat dhe metodat e përdorura nga NjSBC, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Karrierës, si dhe Departamenti janë vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, vëzhgime në auditor. Në RVB përmendet se ka vlerësime paralele, por ne nuk kemi evidencë për to. Gjithashtu, nuk ka evidencë për testime lokale apo të standartizuara, rezultate të arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit, etj. Në FSHMT zhvillohen orë të hapura e workshope, çka flet për përpjekje në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Evidenca: [2], [5], [21].

standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Ndër metodat e instrumentat e tërthortë që UMT përdor për vlerësimin e cilësisë, në RVB, por edhe nga takimet në Institucion përmendet kryerja e pyetsorëve anonimë, rezultatet e të cilave përpunohen nga Sektori i Kurrikulave dhe i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe rezultatet pasyrohen në Raportin Final. ALUMNI mbledh të dhëna në mënyrë periodike, por ky burim ngelet të përmirësohet në të ardhmen. Evidenca: [169], [97]. <i>Vizita në institucion</i>
Konkluzione	<i>UMT monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme, programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Infermieror”, me qëllim që të garantojë arritjen e objektivave formues dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit.</i> <i>Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, Institucion ka përdorur dhe zbaton metodologji vlerësimi të mbarëvajtjes dhe cilësisë të programeve të studimit.</i> <i>Për vlerësimin e cilësisë së programve të studimit janë përdorur një sërë metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në përshtatje me natyrën dhe specifikat e programeve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	FSHMT ka njësinë e tij përkatëse të SBC, e cila përbëhet nga pesë anëtarë: katër anëtarë vijnë nga personeli akademik dhe njëri anëtar është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit, përfaqësues të Universitetit, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i UMT, me të drejtë rizgjedhjeje. Evidenca: [180].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në Rregulloren e UMT dhe NjsBC, çdo department ka përfaqësuesin e vet në NjsBC, i cili ka detyrë adresimin konkret të problematikave të njësisë bazë. Komunikimi me studentët realizohet drejtpërdrejt si komunikim pedagog-student, apo indirekt falë pyetësorëve periodikë. Evidenca: [3], [180].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,	Kuadri ligjor garanton dhe kërkon përfshirjen e Departamentit dhe të anëtarëve të FSHMT në procesin e sigurimit të cilësisë. Njësia bazë, si hallka më e rëndësishme, ku diskutohet rreth nevojave për ndryshime apo për përmirësim në programet e studimit organizon takime të vazhdueshme dhe përfshin të gjithë stafin akademik dhe joakademik në aktivitetin dhe veprimtarinë e NJSBC-së. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC përfaqësues

ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	të njësisë kryesore, njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik ka dhe përfaqësuesin e studentëve. Evidenca: [1], [5], [180].			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në RVB citohet, se procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës, të miratuar në UMT. Parimi bazë që udhëheq procesin e vlerësimit është respektimi i integritetit akademik dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në UMT është ngritur një strukturë e posaçme në mbrojtje të të drejtave të studentëve. Evidenca: [172], [107], [108].			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	NjSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose flon ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në kuadrin e vlerësimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit, janë zhvilluar takime me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas të përzgjedhur nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit. Evidenca: [141].			
Konkluzione	<i>UMT përfshin njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e SBC dhe informon për rezultatet, palët e interesuara në këtë proces.</i> <i>Në aktet e tij të brendshme institucioni rregullon angazhimin e gjithsecilit nëpërmjet përcaktimit të detyrave e përgjegjësi konkrete për të gjithë aktorët e angazhuar.</i> <i>Përfshirja e aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që UMT organizon në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmbledhen në Raportin vjetor, të cilin UMT e publikon për të gjithë të interesuarit përfshirë edhe studentët. Njëkohësisht, ato u bëhen të njohura departamenteve apo strukturave drejtuese nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit. Studentët marrin pjesë në proceset e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Evidenca: [79], [79.1].
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit përmbledhen në raportin vjetor përfundimtar, që NjSBC ia përciell Rektorit dhe Senatit Akademik për veprime të mëtejshme. Përmbledhja e Raportit publikohet pa emra konkretë mbështetur mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Problematikat e evidentuara analizohen dhe diskutohen në mbledhjen e Senatit Akademik, për të adresuar zgjidhjet specifike. Evidenca: [79], [79.1], [172].
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i NjSBC të FSHMT, si dhe plan-masat e sugjeruara nga Fakulteti, si pjesë e raportit të UMT, diskutohen në Senatin Akademik i cili nxjerr vendim me masat dhe rekomandimet përkatëse në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Evidenca: [79], [79.1], [169].
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	UMT nëpërmjet strukturave të veta, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit siguron efektivitetin e veprimtarive.

efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NjSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore e shkencore dhe harton raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Të dhënat e Vlerësimit përdoren për përmirësimin e cilësisë së progrmit të studimit, përmirësimin e shërbimeve dhe performancës së personelit akademik e ndihmësakademik, për planifikimin vjetor e strategjik. Evidenca: [169].			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NjSBC organizon takime periodike me anëtarët e saj, stafi dhe studentët e interesuar njihen me konkluzionet e takimeve, ndërkohë që UMT ka zhvilluar takime me përfaqësues të ASCAL, duke mundësuar informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit dhe konkretisht të programit “Master Profesional në Menaxhim Infermieror”. Evidenca: [141], [180], [141].			
Konkluzione	<i>UMT harton dhe kryen politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Infermieror të cilat janë publike transparente dhe efektive, me synimin e krijimit të kulturës së brendshme.</i> <i>Institucioni ka një politikë si dhe procedura të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore në lidhje me publikimin e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale në përputhje me rregullat e etikës akademike si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në:
“Menaxhim infermieror”**

a. Pikat e forta afirmimet:

1. Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e UMT. Ai bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
2. Si pjesë e programeve të ofruara nga UMT, universitet me traditë dhe histori në fushën e mjekësisë, vlerësuar dhe akredituar për cilësinë e programeve që ofron Universiteti në vështrimin holistic;
3. Programi ofrohet nga FSHMT, me ekspertizë shumëvjeçare në fushën e infermierisë;
4. Institucioni siguron një rrjet të gjerë partnerësh, bashkëpunorësh dhe ekspertesh në garanci të zhvillimit të praktikave klinike dhe përmirësimit të kurrikulave;
5. Programi i studimit garanton nivel të lartë punësimi brenda dhe jashtë vendit;

b. Pikat e dobëta:

1. Shpërndarja e lëndëve të programit të studimit sipas kategorive A, - E në ECTS/ përqindje nuk përputhet me ato të parashikuara në VKM nr. 41 / 2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ;(*Standardi II.1, Kriteri 1*)
2. Disa Syllabuse janë të papërditësuara në literaturë, apo nuk kanë të gjithë elementët e parashikuara në VKM nr. 41 / 2018; (*Standardi II. 4, Kriteri 5; Standardi IV. 3, Kriteri 2*)
3. Në këtë program studimi angazhohen edhe staf akademik me Msc. Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6, neni 59 i Ligjit Nr. 80/ 2015) personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, gradën Dr; (*Standardi IV.1, Kriteri 1*)
4. Në këtë program studimi nuk plotësohen kërkesat ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10. 05. 2017 ku citohet “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi” në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit; (*Standardi IV. 1 Kriteri 2*)

Rekomandime

1. Të rishikohet shpërndarja e veprimtarive të lëndëve në kategori, duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr. 41/ 2018;
2. Të rishikohen titullarët e lëndëve dhe të përshtaten në kategori sipas kërkesave ligjore;
3. Të përditësohet literatura në disa prej syllabuseve lëndore;
4. Në realizimin e programit të studimit të angazhohen në mësimdhënie vetëm staf akademik me të paktën gradën shkencore Dr. në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
5. Të rishikohet shpërndarja e ngarkesës midis PAE dhe PAK, në përputhje me ligjin që citon për PAE jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore;
6. Të përmirësohet dhe përditësohet fondi fizik dhe online i bibliotekës së FSHMT;
7. Të përfshihen institucione në përmirësimin e programit të studimit;
8. Sugjerojmë që programi të përmbajë një lëndë të teknologjisë së informacionit, të nevojshme për nivelin aktual të shërbimit shëndetsor.



**Conclusions of the Evaluation of the second cycle Professional Master's study program in:
"Nursing management"**

a. Strong points and affirmations:

1. The study program is designed and developed in accordance with the mission, objectives and strategy of UMT. It is based on the legal and sub-legal acts in force;
2. As part of the programs offered by UMT, a university with a tradition and history in the field of medicine, evaluated and accredited for the quality of the programs offered by the University in a holistic perspective;
3. The program is offered by MTSF, with many years of expertise in the field of nursing;
4. The institution provides a wide network of partners, collaborators and experts to guarantee the development of clinical practices and the improvement of curricula;
5. The study program guarantees a high level of employment at home and abroad;

b. Weaknesses:

1. The distribution of study program subjects according to categories A, - E in ECTS/percentage does not comply with those provided for in the Council of Ministers No. 41 / 2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions"; (*Standard II.1, Criterion 1*)
2. Some syllabi are outdated in the literature, or do not have all the elements provided for in the Council of Ministers No. 41 / 2018; (*Standard II. 4, Criterion 5; Standard IV. 3, Criterion 2*)
3. Academic staff with Msc are also engaged in this study program. According to the legal provisions (point 6, article 59 of Law No. 80/ 2015) academic staff engaged in teaching must have at least the next cycle qualification, the Dr degree; (*Standard IV.1, Criterion 1*)
4. This study program does not meet the legal requirements regarding the coverage of the workload by effective academic staff, according to DCM No. 418, dated 10. 05. 2017, which states that "Full-time academic staff must cover no less than 70% of the teaching workload for each study program" in accordance with the field of qualification and research field of the staff members; (*Standard IV. 1 Criterion 2*)



Recommendations

1. Review the distribution of course activities in categories, respecting their weight according to DCM No. 41/ 2018;
2. Review the course titles and adjust them to categories according to legal requirements;
3. Update the literature in some of the subject syllabi;
4. In the implementation of the study program, only academic staff with at least the scientific degree of Dr. should be engaged in teaching in accordance with the legal requirements in force for the appropriate level of academic qualification;
5. To review the distribution of the workload between PAE and PAK, in accordance with the law that cites for PAE no less than 70% of the teaching load;
6. To improve and update the physical and online collection of the MTSF library;
7. To involve institutions in improving the study program;
8. We suggest that the program include an information technology course, necessary for the current level of health service;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X